

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN “PËR DHOMËN EKONOMIKE KOMBËTARE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji “Për Dhomën Ekonomike Kombëtare” ka si qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë të Dhomës Ekonomike Kombëtare. Ky projektligj vjen si nevojë e reformimit të modelit aktual të dhomave të tregtisë dhe industrisë, duke synuar një organizim të ri nëpërmjet krijimit të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Me gjithë përpjekjet ndër vite për të fuqizuar dhomat e tregtisë dhe industrisë dhe Bashkimin e Dhomave, të krijuara sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”, të ndryshuar, përfaqësimi i biznesit shqiptar në dhoma është shumë i ulët në raport me subjektet tregtare në vend. Shërbimet e ofruara nga sistemi i dhomave prej vitit 2006 janë të limituara, ndikuar kjo jo vetëm nga shkalla e ulët e ndërgjegjësimit të bizneseve, por edhe nga problemet financiare që kanë hasur dhomat e krijuara me ligjin nr. 9640, datë 9.11.2006, i cili ka pësuar ndryshime si përpjekje për të fuqizuar sistemin e dhomave publike, përpjekje këto që në praktikë sollën pak efikasitet dhe efikasitet.

Hartimi i këtij projektligji erdhi si nevojë për të pasur një dhomë ekonomike publike gjithëpërfshirëse dhe të fuqizuar financiarisht, ku gjejnë përfaqësim të gjitha kategoritë e biznesit, të cilat organizohen në nivel qendror dhe rajonal duke i dhënë paralelisht rol përfaqësimit të sektorëve të veçantë të ekonomisë. Ky projektligj ofron një model kontinental të organizimit dhe funksionimit të Dhomës Ekonomike Kombëtare, që ngjason me dhomat simotra në vende të tjera si Austria, Italia, Kroacia, Greqia, Gjermania, Serbia etj., por duke e harmonizuar me Kushtetutën e Shqipërisë dhe legjislacionin tonë të brendshëm në fuqi. Duhet theksuar se nuk ka një model të unifikuar të organizimit të dhomave ekonomike e të biznesit në vendet anëtare të Bashkimit Evropian apo më gjerë. Kjo është një çështje e brendshme dhe zgjedhje e shteteve në varësi të tipareve që ka ekonomia dhe traditës juridike. Shumica e modeleve në Evropë priren drejt dhomave gjithëpërfshirëse me anëtarësi të detyruar, ku brenda tyre ndërveprojnë të gjitha dhomat ekonomike, profesionale dhe shoqatat. Në kushtet e Shqipërisë, ku legjislacioni është i fragmentarizuar duke parashikuar me ligj të veçantë një sërë dhomash/urdhrash profesionalë dhe mbi të gjitha për të garantuar parimet e Kushtetutës, projektligji synon një sistem të unifikuar dhomash publike që nuk bëhet ombrellë e detyrueshme për çdo dhomë/urdhër të krijuar me ligj të veçantë apo dhomat ekonomike bilaterale/ shoqatat multilaterale të krijuara sipas të drejtës private. Synimi i këtij ligji është krijimi i një sistemi të unifikuar dhomash ekonomike publike, që vepron për interes publik, është funksional dhe ofron shërbime cilësore për anëtarët e saj.

Momenti i propozimit të këtij projektligji përkon me proceset e brendshme të ndërmarra për përgatitjen e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Edhe pse nuk ka një *acquis communautaire* për dhomat ekonomike, është tashmë e qartë për çdo institucion publik dhe

çdo subjekt privat se në kuadër të procesit të integrimit evropian, subjektet tregtare në Shqipëri duhet të jenë të gatshme të përballojnë rregullat e tregut evropian, të operojnë me standarde dhe të kenë punonjës të kualifikuar për të përballuar konkurrencën. Dhoma Ekonomike Kombëtare duhet të jetë në gjendje t'i përgjigjet sfidave të kohës dhe ky projektligj synon t'i japë një rol kryesor në këtë drejtim. Projektligji parashikon ngritjen e Qendrës së Integrimit Ekonomik Evropian në DHEK e cila do të ndihmojë në integrimin evropian të vendit, duke bashkëpunuar në proceset e përafrimit të legjislacionit, informimit të vazhdueshëm të anëtarëve të DHEK për Tregun e Përbashkët Evropian dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe do të ofrojë trajnime të vazhdueshme në fusha që përbëjnë interes për proceset integruese të vendit.

Në bazë të projektligjit, DHEK parashikohet të ketë fizionominë e një organi publik që jo vetëm ofron shërbime publike të përcaktuara nga ligji i saj i posaçëm, të deleguara me ligje të tjera apo me marrëveshje nga organet e tjera publike, por lobon për politikën në fushën e ekonomisë, përcjellë zërin e anëtarëve të saj në proceset e hartimit të legjislacionit, ndihmon në rritjen e kapaciteteve të bizneseve, nxit konkurrencën në vend dhe shërben si një urë lidhëse për të bashkërenduar nismat me aktorët e tjerë që veprojnë në këtë fushë.

Organet e DHEK ngrihen në nivel qendror dhe rajonal dhe në ndryshim nga ligjet që kanë rregulluar dhomat e industrisë dhe tregtisë prej vitit 1993 në Shqipëri, projektligji sjell një organizim me fokus sektorët dhe nënsektorët e ekonomisë, si dhe krijon terrenin për forume aktive dhe këshillimore pranë DHEK për të gjitha kategoritë e biznesit.

Të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të jenë anëtare të DHEK, me përjashtim të subjekteve që janë anëtarë në dhoma apo urdhra profesionalë të krijuar me ligj të veçantë.

Rregullat për anëtarësimin në organin publik DHEK nuk prekin organizimet ekzistuese apo të atyre që mund të krijohen në të ardhmen në formën e shoqatave, fondacioneve, organizatave jofitimprurëse etj. DHEK nuk është shoqatë dhe organizim vullnetar në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës, por subjekt i së drejtës publike që vepron për interes publik, model i ngjashëm me dhomat dhe urdhrat profesional në vend apo dhomat ekonomike e tregtare simotra në shtete të tjera.

Projektligji synon fuqizimin financiar të DHEK, si organ publik jo shtetëror, të ardhurat financiare të DHEK gjenerohen, menaxhohen dhe kontrollohen në format e parashikuara në këtë projektligj dhe legjislacioni në fuqi.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projektligji nuk është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2024. Theksojmë se ky projektligj pasqyron vizionin dhe vendosmërinë e Këshillit të Ministrave për fuqizimin dhe mbrojtjen e sipërmarrjes, si dhe për përmirësimin e klimës së biznesit.

Projektligji është parashikuar në planin vjetor të punës për vitin 2024 të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Dhoma Ekonomike Kombëtare (DHEK) është konceptuar si person juridik publik i krijuar me ligj, jo shtetëror dhe ka autonomi organizative, funksionale dhe financiare. Në raport me pushtetin ekzekutiv, DHEK nuk ka raporte varësie apo hierarkie, por duke ruajtur balancën mes autonomisë së brendshme të DHEK dhe ruajtjes së interesit publik, ministri përgjegjës për sipërmarrjen merr rolin e organit miratues për disa vendimmarrje që prekin interesa të gjera të biznesit, të përcaktuara shprehimisht në ligj.

Të ardhurat e DHEK gjenerohen nëpërmjet tarifave vjetore të anëtarësisë, tarifave për shërbimet që ofron, kontributeve e donatorëve vendas dhe të huaj, donacioneve të anëtarëve të saj dhe burimeve të tjera, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin. Në këtë mënyrë funksionaliteti dhe veprimtaria e DHEK nuk varet nga buxheti shtetit dhe organe të tjera për të siguruar veprimtarinë e saj. Për të siguruar transparencën në përdorimin e fondeve parashikohet ngritja e Komisionit të Auditit, i cili zgjidhet me shumicën e votave nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare me propozim të Bordit Drejtues të DHEK dhe ka 5 anëtarë ekspertë të jashtëm, me të drejtë rizgjedhje një herë dhe me mandat 5 vjeçar. Gjithashtu, për auditimin e pasqyrave financiare të DHEK dhe dhomave ekonomike rajonale, DHEK duhet të lidhë marrëveshje me një kompani auditimi ndërkombëtare të certifikuar.

DHEK organizohet në nivel qendror dhe në dhoma ekonomike rajonale. Projektligji parashikon edhe krijimin e këshillave sektorial dhe ndërsektorial, në nivel kombëtar dhe rajonal, si një mundësi e organizimit të subjekteve tregtare në bazë të natyrës së aktivitetit të tyre. Kjo do të bëjë të mundur zhvillimin e projekteve/programeve të veçanta dhe përpunimin e mendimeve, opinionëve, rekomandimeve, statistikave të anëtarëve të DHEK sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Ngritja e këshillave sektorial dhe ndërsektorial është e lidhur me Kodet NACE dhe aktivitetin e subjekteve tregtare.

Në të njëjtën linjë, për të forcuar dialogun dhe bashkëpunimin e subjekteve tregtare për fusha apo kategori të veçanta, projektligji parashikon ngritjen e Këshillit Konsultativ si një organ konsultativ pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare. Ky Këshill ka rol rekomandues për politika në fusha të veçanta, bashkëpunon me organet e DHEK, si dhe mund të organizojë aktivitete dhe iniciativa të përbashkëta me sistemin e dhomave.

Si çdo organ publik në vend, që krijohet për të ndjekur dhe garantuar funksione e qëllime publike, ligji përcakton funksionet e DHEK, i cili ndër të tjera ka të drejtën e bashkëpunimit me organe të tjera qëndore dhe vendore, të shkëmbejë dhe të marrë informacion, të propozojë përmirësimin e legjislacionit, të marrë pjesë në dëgjesa publike dhe të japë opinionin për nisma ligjore/politika/strategji që prekin biznesin. Në përputhje me funksionet dhe tagrat ligjore të dhëna nga ky projektligj apo me ligje të tjera, DHEK ka të drejtën e bashkëpunimit me subjekte të tjera siç mund të jenë organizatat, dhomat bilaterale, shoqatat bilaterale e

multilaterale, grupimet etj. Kompetencat e përmendura në projektligj nuk janë shterruese sepse llojet e ndryshme të dokumentave që lëshon DHEK, shërbimet në fushën e edukimit profesional, mbajtja e regjistrave të caktuar etj., mund përcaktohen me akte të tjera ligjore të posaçme.

Nga momenti i hyrjes në fuqi i ligjit, për vitin e parë subjektet tregtare nuk do të paguajnë tarifë. Në këtë mënyrë, i jepet kohë dhe mbështetje konstituimit të DHEK, përcaktimit të tarifave pas organizimit të zgjedhjeve të para për organet drejtuese të DHEK dhe për të krijuar mundësinë e informimit të subjekteve tregtare në shkallë kombëtare për risitë e ligjit.

Projektligji parashikon se organizimi dhe funksionimi i plotë i Dhomës Ekonomike Kombëtare kalon në një periudhë kalimtare, e cila zgjat deri në 31 dhjetor 2025 dhe do të mbështetet financiarisht nga buxheti i shtetit. Gjatë kësaj periudhe kalimtare, një Komision i Përkohshëm Teknik do të ngrihet për të siguruar organizimin e zgjedhjeve të para dhe mbështetjen për ngritjen e strukturës administrative.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe është në harmoni me Kodin e Procedurave Administrative dhe me legjislacionin në fuqi për regjistrimin e biznesit dhe organizatat jofitimprurëse.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE**

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.**

Projektligji ka 8 krerë të cilat përcaktojnë organizimin, funksionet dhe rregullat bazë të veprimtarisë të DHEK dhe 1 kre të veçantë për dispozitat kalimtare.

Në **kreun I**, *Dispozita të Përgjithshme*, përcaktohen parimet e përgjithshme në të cilat bazohet veprimtaria e DHEK, dhomave ekonomike rajonale, këshillave sektorial e ndërsektorial, dhe këshillit konsultativ. Në këtë kre, në nenet 3 dhe 4 parashikohen tiparet kryesore të DHEK dhe dhomave ekonomike rajonale si persona juridikë publikë. Numri i dhomave ekonomike rajonale nuk është përcaktuar në projektligj, por është parashikuar se ministri përgjegjës për sipërmarrjen do të përcaktojë me vendim numrin e tyre duke mbajtur në konsideratë ndarjen administrative territoriale, në nivel qarku ose të ngjashëm. Për të shmangur ndërhyrjet e mundshme në ligj në varësi të ndryshimit të ndarjes administrative territoriale, duke qenë se termi “rajon” nuk përmendet në legjislacionin fuqi, por edhe për të krijuar mundësinë e organizimit të dhomave ekonomike rajonale në raport me numrin e subjekteve tregtare, ministrit përgjegjës për sipërmarrjen i ngarkohet nxjerrja e një akti nënligjor në këtë drejtim.

Gjithashtu, në nenin 5 parashikohet mundësia e ngritjes së këshillave sektorial dhe ndërsektorial në nivel kombëtar dhe rajonal, si mekanizma kolegjalë që përcjellin zërin e

sektorëve të veçantë të ekonomisë në organet drejtuese të DHEK. Sektorët kryesor të ekonomisë dhe nënsektorët për të cilët do të ngrihen këshillat sektorial dhe ndërsektorial përcaktohen në Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare, duke mbajtur në konsideratë natyrën e aktivitetit ekonomik dhe peshës që kanë në rajon. Përcaktimi i tyre me Statutin e DHEK krijon hapësirën e rishikimit të sektorëve dhe nënsektorëve, në varësi të ndryshimeve faktike që mund të ndodhin me natyrën e aktivitetit ekonomik në rajone të ndryshme.

Neni 6 i këtij projektligji parashikon ngritjen e Këshillit Konsultativ si një strukturë jo vendimmarrëse por si një organ konsultativ pranë Dhomës Ekonomike Kombëtare. Ky Këshill ka rol rekomandues për politika në fusha të veçanta, bashkëpunon me organet e Dhomës Ekonomike Kombëtare, si dhe mund të organizojë aktivitete dhe nisma të përbashkëta me sistemin e dhomave. Në mbështetje të këtij Këshilli mund të ngrihet një sekretariat teknik, i cili miratohet nga Bordi i Dhomës Ekonomike Kombëtare. E drejta e pjesëmarrjes në këtë këshill mund të jetë për anëtarët e dhomave të tjera ose organizatave jofitimprurëse që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, që nuk janë krijuar sipas parashikimeve të këtij projektligji. Në çdo rast, rregullat e detajuara për pjesëmarrjen në Këshillin Konsultativ, organizimin dhe funksione të tjera të Këshillit Konsultativ, do të përcaktohen në Statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Në nenin 7 është përcaktuar se përdorimi i emërtimeve “Dhomë Ekonomike”, “Dhomë Ekonomike Kombëtare” dhe “Dhomë Ekonomike Rajonale” është i rezervuar për subjektet, që krijohen në përputhje me dispozitat e këtij projektligji. Këto emërtime, lejohen të përdoren edhe nga ato shoqata të bashkimit vullnetar të bizneseve, të cilat kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve për anëtarët e tyre, si dhe promovimin e tregtisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një vendi tjetër, të cilat njihen zyrtarisht nga institucionet përkatëse simotra të vendit tjetër dhe autorizohen nga DHEK. Në mënyrë të ngjashme me ligjin nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”, të ndryshuar, është kufizuar përdorimi i emërtesave, por ky projektligj parashikon rregulla më të thjeshta për shoqatat e bashkimit vullnetar të bizneseve, duke mos vendosur kufizime për numrin e anëtarëve të tyre.

Në **kreun II**, *Objekti i veprimtarisë dhe funksionet*, renditen funksionet e DHEK, dhomave ekonomike rajonale dhe këshillave sektorial e ndërsektorial. Këto funksione nuk janë shteruese, pasi me ligj apo me marrëveshje mund t’i delegohen funksione nga organe të tjera publike.

Në nenin 8 përcaktohen funksionet e DHEK në drejtim të përfaqësimit dhe promovimit të interesave të përgjithshme dhe të ligjshme të anëtarëve të saj. Në drejtim të nxitjes së veprimtarisë ekonomike, konkurrencës së ndershme, si dhe bashkëpunimit ekonomik tregtar me jashtë. DHEK organizon, administron dhe financon ekspozita dhe panaire, kurse dhe trajnime në nivel kombëtar, si dhe çdo veprimtari tjetër në interes të anëtarëve të saj.

Projektligji parashikon se DHEK do të krijojë Qendrën e Integritit Ekonomik Europian dhe ofron trajnime të vazhdueshme profesionale për fuqizimin dhe aftësimin e punonjësve dhe sipërmarrësve. Ndër të tjera, krijon projekte dhe programe financimi për të mbështetur gratë në sipërmarrje, të rinjtë, projektet inovative, rritjen e bashkëpunimit me diasporën,

ekonominë e gjelbër etj. Gjithashtu, DHEK duhet të japë mendime, propozime dhe të shprehet për nismat ligjore apo politikat publike të ndërmarra nga Qeveria, përmbajtja e të cilave lidhet me interesat e anëtarëve të saj.

Në përmbushje të objektivave dhe interesave të ligjshme të subjekteve tregtare, DHEK mund të krijojë Qendrën e Ndërmjetësimit Ekonomik, si dhe të ngrej Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit të saj.

Në nenin 9 përcaktohen funksionet e dhomave ekonomike rajonale të cilat përfaqësojnë interesat ekonomike dhe juridike të anëtarëve që janë në juridiksionin e tyre. Në dijëni me organet drejtuese të DHEK, dhomat ekonomike rajonale bashkëpunojnë me organe publike, donatorë, organizata jofitimprurëse për zhvillimin e projekteve dhe programeve që kanë ndikim në juridiksionin e tyre. Në koordinim me organet drejtuese të DHEK, ato japin mendime, propozime dhe vlerësime për nismat ligjore apo politikat publike, të ndërmarra nga administrata qendrore, vendore dhe subjektet e tjera publike, përmbajtja e të cilave prek interesat e çdo dege dhe gjithë subjekteve tregtare. Gjithashtu, dhomat ekonomike rajonale mbledhin dhe përpunojnë të dhëna statistikore për anëtarët në juridiksionin e tyre, si dhe në dijëni me organet drejtuese të DHEK organizojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e subjekteve tregtare në panairë dhe ekspozita me karakter vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni i 10 i projektligjit përcakton objektin e veprimtarisë dhe funksionet bazë të këshillave sektorial dhe ndërsektorial, në nivel kombëtar dhe rajonal duke parashikuar se ato përfaqësojnë interesat e subjekteve tregtare sipas sektorëve të ekonomisë ku ushtrojnë veprimtarinë dhe përcjellin kërkesat dhe mendimet e tyre pranë pushtetit qendror dhe vendor, në koordinim me organet drejtuese të DHEK. Anëtarësia e tyre përcaktohet sipas kodit të aktivitetit NACE dhe numrit të subjekteve tregtare sipas kategorive të veçanta të biznesit.

Në **kreun III**, *Anëtarësia*, përcaktohen subjektet që janë anëtarë të DHEK dhe rregullat bazë për tarifën vjetore të regjistrimit në DHEK.

Projektligji ka parashikuar se regjistrimi në Dhomën Ekonomike Kombëtare është i detyrueshëm për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të subjekteve që janë të regjistruara në një Dhomë apo urdhër profesional të krijuar me ligj të veçantë. Për subjektet tregtare, biznes i vogël, përcaktohet se paguajnë një tarifë vjetore regjistrimi në vlerën 1000 (njëmijë) lekë. Ndërsa, për subjektet e tjera tregtare sipas kategorive përkatëse, tarifa vjetore e regjistrimit vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e DHEK, bazuar në kriteret e përcaktuara në statutin e DHEK. Tarifa vjetore e regjistrimit sipas kategorive përkatëse dhe kriterëve statutorë do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme e DHEK, si organi kolegjal më i madh i dalë nga zgjedhjet periodike dhe ku gjejnë përfaqësim të gjitha dhomat rajonale. Në varësi të situatës ekonomike, nevojave të DHEK apo me kërkesë të subjekteve tregtare, DHEK mund të rishikojë vendimmarrjen e saj.

Për të mos penguar regjistrimin e bizneseve të reja, projektligji ka parashikuar një tarifë vjetore regjistrimi fikse në DHEK për të gjitha subjektet tregtare që regjistrohen për herë të parë në QKB, në vlerën 1000 (njëmijë) lekë. Të gjitha subjektet tregtare që janë objekt

rregullimi i këtij projektligji dhe që regjistrohen për herë të parë, detyrohen të depozitojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, edhe dokumentin që vërteton pagesën e tarifës vjetore të regjistrimit në DHEK.

Tarifa vjetore e regjistrimit për anëtarët e dhomave bilaterale dhe multilaterale është 1000 (njëmijë) lekë. Për këta anëtarë, tarifa është fikse e përcaktuar nga ligji, për të mos rënduar financiarisht subjektet tregtare që paralelisht paguajnë tarifa në dhomat bilaterale dhe multilaterale, dhe mbi të gjitha sepse anëtarët e këtyre dhomave e kanë të lidhur anëtarësinë e tyre në këto dhoma me përfaqësimin e interesave të shteteve të tjera. Anëtarët e dhomave dhe shoqatave bilaterale, vërtetojnë dhe njoftojnë anëtarësinë apo regjistrimin e tyre në këto dhoma, pranë DHEK brenda datës 30 prill të çdo viti. Ky parashikim nuk shtrihet për organizatat apo shoqatat që nuk promovojnë tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një vendi tjetër dhe që nuk njihen zyrtarisht nga institucionet përkatëse simotra të vendit tjetër. Anëtarësia në DHEK si dhomë publike, nuk pengon anëtarët e saj të krijojnë organizata, shoqata apo fondacione si persona juridikë privatë dhe liria e organizimit/anëtarësia në to nuk mund të shërbejë si shkak për të shmangur tarifën vjetore të regjistrimit në organin publik.

Anëtarët e Dhomës Ekonomike Kombëtare pajisen me kartën e regjistrimit nga Dhoma, pasi të kenë kryer pagesën e plotë të regjistrimit, sipas rregullave të detajuara në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare. Anëtarët që nuk paguajnë tarifën vjetore të regjistrimit nuk marrin pjesë në procesin zgjedhor për organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare, dhomave ekonomike rajonale dhe këshillave sektorial e ndërsektorial, si dhe nuk përfitojnë shërbimet e ofruara nga Dhoma Ekonomike Kombëtare.

Anëtarët e Dhomës Ekonomike Kombëtare paguajnë tarifën vjetore të regjistrimit brenda datës 30 prill të çdo viti. Nga momenti i hyrjes në fuqi i ligjit, për vitin e parë subjektet tregtare nuk do të paguajnë tarifë. Kjo periudhë do të mbështetet financiarisht sipas parashikimeve të dispozitave tranzitore nga buxheti i shtetit.

Në nenin 12 parashikohet forma e regjistrimit të anëtarësisë të DHEK dhe regjistrave të dhomave ekonomike rajonale. Regjistrat janë parashikuar të jenë elektronikë dhe mënyra e mbajtjes së tyre përcaktohet me vendim të Bordit të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Në **kreun IV**, *Organet dhe kompetencat*, projektligji përcakton organet drejtuese të DHEK dhe dhomave ekonomike rajonale, si dhe strukturën organizative të këshillave sektorial dhe ndërsektorial.

Në nenet 13 - 20 të projektligjit parashikohen organet drejtuese të DHEK, përbërja e tyre, mënyra e zgjedhjes, shkarkimi dhe kompetencat e tyre. Paralelisht me organet drejtuese, projektligji ka parashikuar në nenin 21, Komisionin e Auditit të Dhomës Ekonomike Kombëtare, si strukturë e përhershme pranë DHEK, e përbërë nga 5 anëtarë ekspertë të jashtëm, me të drejtë rizgjedhje një herë dhe me mandat 5 vjeçar. Komisioni i Auditit ushtron kontroll financiar të brendshëm në Dhomën Ekonomike Kombëtare, dhomat ekonomike rajonale, si dhe këshillat sektorial dhe ndërsektorial. Procedura e detajuar e zgjedhjes dhe kompetencat e Komisionit të Auditit përcaktohen në statutin e Dhomës Ekonomike

Kombëtare. Për të garantuar transparencë financiare më të plotë, projektligji parashikon se për auditimin e pasqyrave financiare të Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe dhomave ekonomike rajonale, DHEK duhet të lidhë marrëveshje me një kompani auditimi ndërkombëtare të certifikuar.

Në nenet 22 - 29 të projektligjit parashikohen organet drejtuese të dhomave ekonomike rajonale, përbërja e tyre, mënyra e zgjedhjes, shkarkimit dhe kompetencat e tyre. Ndërsa në nenin 30 janë përcaktuar rregullat bazë për strukturimin e këshillave sektorial dhe ndërsektorial në nivel kombëtar dhe rajonal. Në këtë nen, projektligji ka deleguar në statutin e DHEK përcaktimin e rregullave më të detajuara, për ngritjen, organizimin e veprimtarinë e tyre dhe procesin zgjedhor.

Në **kreun V**, *Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit*, parashikohet ngritja e Gjykatës së Përhershme e Arbitrazhit të DHEK, si person juridik, për të qenë kompetente për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat rrjedhin nga një marrëdhënie juridike e caktuar, që kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet subjekteve tregtare vendase dhe/ose të huaja, në përputhje me ligjin për arbitrazhin. Në çdo rast, rregullat e detajuara për ngritjen e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, forma e organizimit, veprimtaria, kompetencat dhe procedurat do të përcaktohen në statutin e Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe në aktin e themelimit të kësaj gjykate.e

Në **kreun VI**, *Statuti*, përcaktohen elementët kryesorë që duhet të përmbajë Statuti i DHEK dhe i dhomave ekonomike rajonale. Statuti i DHEK miratohet nga Asambleja e Përgjithshme. Në rastin e statuteve të dhomave rajonale, procesi i miratimit kalon nëpërmjet vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme të dhomave ekonomike rajonale. Sipas nenit 33, pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme, statuti dërgohet pranë Bordit të Dhomës Ekonomike Kombëtare për miratim lidhur mbi përputhshmërinë ligjore. Statuti i dhomave ekonomike rajonale duhet të jetë në përputhje me statutin e DHEK.

Në **kreun VII**, *Financimi dhe Prona*, përcaktohen burimet e financimit të DHEK dhe dhomave ekonomike rajonale. Në nenin 34, ndër të tjera parashikohet që në çdo rast, buxheti vjetor i DHEK duhet të garantojë funksionimin minimal të strukturave rajonale dhe sektoriale. Në nenin 36, përcaktohet e drejta e DHEK për të vendosur tarifa për shërbimet që ofron. Vlera e tarifave përcaktohet me vendim të Bordit dhe me miratim të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen. Në rast të shtimit të funksioneve për DHEK, Bordi Drejtues mund të caktojë tarifa për shërbime të veçanta që ofron sistemi i dhomave, por këto tarifa nuk duhet të jenë abuzive dhe duhet të jenë në përputhje me koston që ka DHEK për ofrimin e tyre. Miratimi nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen është një garanci e shtuar për të mbrojtur biznesin nga çdo situatë që potencialisht mund të rëndojë mbi ta. Për shërbimet publike të ofruara, DHEK paraqet një raport vjetor pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen, i cili monitoron ofrimin e këtyre shërbimeve.

DHEK në përmbushje të funksioneve të saj, ka të drejtën e krijimit, mbledhjes dhe shpenzimit të të ardhurave. Ajo ka të drejtë të fitojë dhe të krijojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme me burime të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat

regjistrohen dhe administrohen prej saj, sipas legjislacionit në fuqi. Si person juridik, DHEK ushtron të gjitha të drejtat e njohura nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në **kreun VIII**, *Zgjedhjet, E drejta e votës dhe Kandidimi*, përcaktohen parimet bazë për organizimin e zgjedhjeve të organeve drejtuese të DHEK, dhomave ekonomike rajonale dhe këshillave sektorial e ndërsektorial. Zgjedhjet e organeve drejtuese të DHEK dhe dhomave ekonomike rajonale organizohen nga Komisioni i Zgjedhjeve, i cili përbëhet nga një kryetar, zëvendësi i tij dhe 3 anëtarë të tjerë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Ekonomike Kombëtare dhe Asambletë e dhomave rajonale. Rregulla të tjera më të detajuara për organizimin e zgjedhjeve do të përcaktohen në rregulloren e Komisioneve Zgjedhore të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e DHEK. Ndërsa, rregullat më të hollësishme për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit zgjedhor, funksionimin dhe procedurën e certifikimit të rezultetit, përcaktohen në Statutin e DHEK.

Në **kreun IX**, *Dispozitat të fundit dhe kalimtare*, përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e subjekteve ekzistuese të krijuara sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, të komisionit të përkohshëm teknik e zgjedhor, të organizimit të zgjedhjeve të para dhe të financimit fillestar.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, duhet të paraqesin pranë Komisionit të Përkohshëm Teknik një raport të detajuar në lidhje me aktivitetin e tyre deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Komisioni i Përkohshëm Teknik, në bashkëpunim me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, miraton planin e veprimit për periudhën tranzitore deri në certifikimin e zgjedhjeve të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

Me fillimin e procesit të parë zgjedhor, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, do të vijojnë veprimtarinë e tyre në dakordësim të plotë me Komisionin e Përkohshëm Teknik.

Për të garantuar dhe siguruar një proces parazgjedhor dhe zgjedhor të paanëshëm, kushte dhe trajtim të barabartë të kandidatëve për organet drejtuese të dhomave ekonomike rajonale dhe Dhomës Ekonomike Kombëtare, gjatë periudhës 3 mujore të zgjedhjeve deri në certifikimin e zgjedhjeve të Dhomës Ekonomike Kombëtare, veprimtaria e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, do të jetë e kufizuar sipas rregullave dhe përcaktimeve të miratuara në rregulloren e përkohshme zgjedhore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit deri në zgjedhjen e organeve drejtuese të DHEK dhe dhomave ekonomike rajonale, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, marrin përsipër të drejta dhe detyrime edhe të reja, si dhe kryejnë veprime financiare me palë të treta, me dakordësimin e kryetarit të Komisionit të Përkohshëm Teknik.

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, përgatisin dhe dorëzojnë pasqyrat financiare brenda datës 31.1.2025.

Në nenin 42, është përcaktuar se organizimi dhe funksionimi i plotë i Dhomës Ekonomike Kombëtare kalon në një periudhë kalimtare, e cila zgjat deri në 31 dhjetor 2025. Drejtimi i veprimtarisë së Dhomës Ekonomike Kombëtare gjatë periudhës kalimtare kryhet nga Komisioni i Përkohshëm Teknik, i cili ka 7 anëtarë (2 anëtarë ekspert në fushën e ekonomisë, 1 anëtar ekspert kontabilist, 2 anëtarë ekspert jurist dhe 2 anëtarë nga Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, të krijuara në çdo qark ose Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë që kanë funksionuar sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar). Ky komision do të ngrihet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen 15 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit. Për të shmangur konfliktin e interesit dhe ndikimin në procesin e ndërtimit të DHEK, në nenin 42 të projektligjit është parashikuar se anëtarët e Komisionit të Përkohshëm Teknik nuk mund të jenë të zgjedhur në organet drejtuese të sistemit të dhomave të ngritura sipas ligjit nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar, si dhe nuk mund të kandidojnë në zgjedhjet e para për organe drejtuese në DHEK dhe dhomat ekonomike rajonale. Kompetencat e Komisionit të Përkohshëm Teknik përcaktohen në nenin 43.

Me qëllim organizimin e zgjedhjeve të para, në nenin 44 është përcaktuar se ministri përgjegjës për sipërmarrjen, ngre një komision të përkohshëm zgjedhor, i cili organizon zgjedhjet e para të DHEK, dhomave ekonomike rajonale dhe këshillave sektorial e ndërsektorial në nivel kombëtar dhe rajonal, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen miraton rregulloren e përkohshme zgjedhore të propozuar nga Komisioni Përkohshëm Teknik për të siguruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Në nenin 45 parashikohet se procesi kalimtar për ngritjen e Dhomës Ekonomike Kombëtare, dhomave ekonomike rajonale dhe këshillave sektorial e ndërsektorial subvencionohet nga shteti deri në 31.12.2025, duke filluar që nga momenti i nisjes të punës së Komisionit të Përkohshëm Teknik.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji Këshilli i Ministrave, ministri përgjegjës për sipërmarrjen, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, si dhe organet drejtuese të Dhomës Ekonomike Kombëtare.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për hartimin e këtij projektligji kanë kontribuar një grup i përbashkët pune i ngritur me urdhër të Kryeministrit, përfaqësues të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen, të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, të agjencisë për zhvillimin e investimeve, të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, ekspertë të fushës dhe përfaqësues të biznesit.

Në kuadër dhe në mbështetje të hartimit të projektligjit, projektakti ka qenë objekt diskutimi në dy mbledhje të Këshillit Ekonomik Kombëtar, si dhe janë zhvilluar takime e tryeza publike të zgjeruara me përfaqësues të organizatave të biznesit, të shoqatave bilaterale dhe multilaterale, si dhe të dhomave bilaterale, duke diskutuar shqetësimet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit në mbështetje të procesit kalimtar dhe veprimtarisë të Komisionit të Përkohshëm Teknik, për të bërë të mundur konstituimin e Dhomës Ekonomike Kombëtare. Paraprakisht, për vitin e parë parashikohet të jetë 40,000,000 (dyzet milionë) lekë ndërsa për vitin e dytë parashikohet të jetë rreth 100,000,000 (njëqind milion) lekë.

**MINISTRI**

**Delina Ibrahimaj**